

**KORPORATA ENERGETIKE
E KOSOVËS**

**Raporti i auditorëve të pavarur dhe
pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor
2002**

PËRMBAJTJA

	Faqe
Përgjegjësia e menaxhmentit	
Raporti i auditorëve të pavarur	
Pasqyra me 31 dhjetor 2002 dhe 2001	1
Pasqyra e të hyrave për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2002 dhe 2001	2
Pasqyrat për ndryshimet në kapitalin e pronarit për vitet e përfunduara 31 dhjetor 2002 dhe 2001	3
Pasqyrat për qarkullimin e parasë për vitet e përfunduara 31 dhjetor 2002 dhe 2001	4
Vërejtjet në Pasqyrat financiare	5 - 16

PËRGJEGJËSIA E MENAXHMENTIT PËR BILANCET FINANCIARE TË KORPORATËS ENERGJETIKE TË KOSOVËS

Bilancet financiare përcjellëse të Korporatës Energjetike të Kosovës (në vazhdim të tekstit si “KEK”) janë përgjigjësi dhe janë miratuar nga Menaxhmenti.

Shmangiet nga Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar:

- Nuk është bërë vlerësimi i datave të bilancit për shkallën e zhvlerësimit të pronës, objekteve dhe paisjeve, dhe nevojës për uljen e vlerës kontabël për shumën e përtritshme të llogaritur, dhe pasqyrimi i humbjeve si rrjedhojë e zhvlerësimit, siç kërkohet nga Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit nr. 36 “Zhvlerësimi i Mjeteve”(International Accounting Standards – IAS no. 36 “Impairment of assets”).
- Në këto bilance financiare nuk është përfshirë asnjë indeks i lëvizjeve që janë bërë në pronë, objekte dhe paisje, ashtu siç kërkohet nga IAS-I 16 për pronën, objektet dhe paisjet.
- Që nga viti 1999 e këtej, KEK-u ka marrë ndihma financiare të konsiderueshme nga donatorët e jashtëm, të dedikuara kryesisht për riparimin dhe zëvendësimin e pronës, objekteve dhe paisjeve. Përkundër kërkesave të shumta, donatorët nuk ofruan dokumentacionin përkatës për të mundësuar që këto ndihma financiare të regjistrohen conform IAS-it Nr. 20, për kontabilitetin e ndihmave qeveritare.
- Nuk janë bërë ndarje për pjesën e inventarit të vjetër apo me xhirim të ngadalshëm, që isho pjesë e inventarit të tërësishëm të KEK-ut prej 47,710 mijë EURO me 31 dhjetor 2002 dhe 41,317 mijë EURO me 31 dhjetor 2001, sipas IAS-it nr.3 për inventarin, inventaret duhet të regjistrohen sipas çmimit më të ulët dhe vlerës netto të realizueshme, ashtu që të përkujdeset që mjete të mos jenë bartur në vlerë më të lartë nga vlerë e vërtetë e cila duhet të përfitohet nga shitja apo pëdorimi i tyre.

Bilancet financiare përfshijnë shumën të caktuar të cilat rrjedhin nga llogaritjet dhe opinionet më të mira nga dita e fillimit të raportit.

Më përjashtim të efekteve që dalin nga çështjet e lartpërmendura, ne mendojmë se të dhënat e pasqyruara në bilancet përcjellëse dhe bilanci i të hyrave, pastaj ndryshimet në kapitalin e pronarit dhe qarkullimi i parasë, së bashku me të dhënat e prezentuara në vërejtjet përcjellëse, paraqesin denjësisht gjendjen financiare të KEK-ut me 31 dhjetor 2002 dhe 2001, dhe rezultatet, ndryshimet në kapitalin e pronarit dhe qarkullimi i parasë për vitet e mbyllura atëherë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte & Touche, auditorë të pavarur, janë angazhuar për auditimin e këtyre bilanceve financiare, dhe raporti i tyre është përfshirë këtu

Josef Rieder, Drejtor i përgjithshëm

Visar Kelmendi, Drejtor Financiar

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

Për Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit dhe Menaxhmentin e KEK-ut

Ne jemi ftuar për bërë auditimin e bilanceve përcjellëse të Korporatës Energjetike të Kosovës ("KEK"), deri me 31 dhjetor 2002 dhe deri me 31 dhjetor 2001, si dhe bilancin përkatës të të hyrave, bilancin e qarkullimit të parasë dhe bilancin e ndryshimeve në kapital deri në fundvitet e mbyllura atëherë. Këto bilance financiare janë në përgjegjësinë e menaxhmentit të KEK-ut. Ne kemi për detyrë të shprehim pikëpamjet tona përkitazi me këto bilance financiare bazuar në auditimin tone.

Audimi ynë është kryer konform me Standardet ndërkombëtare të auditimit (International Standards on Auditing), përpos çështjeve të përshkruara më poshtë në paragrafet kufizimet në shtrirje. Këto standarde nga ne kërkojnë planifikimin dhe realizimin e auditimit, ashtu që të kemi siguri të arsyeshme që bilancet financiare nuk përmbajnë gabime të konsiderueshme. Audimi përfshin hulumtimin e dëshmive, në bazë të testimeve, të cilat janë mbështetje e shumave dhe gjetjeve në bilancet financiare. Gjithashtu, auditimi përfshin edhe vlerësimin e parimeve të përdorura kontabilitetit dhe logaritjet me rendësi të menaxhmentit, sikurse edhe të evalumimitin e pasqyrimin të përgjithshëm të bilanceve financiare. Ne besojmë që auditimi ynë paraqet bazë të mirëfilltë për opinionin tonë.

Kufizimet në shtrirje

1. Kompletësia e të hyrave

Ekzistojnë dobësi të konsiderueshme në sistemin e kontrollit intern që energjia elektrike e shpenzuar nga konsumatorët të faturohet dhe se të hyrat e arkëtuara janë përlogaritur drejtë. Në mungesë të kontrollit themelor në faturim dhe arkëtim, nuk ekzistonin procedura tjera alternative që mund t'i përdornim të vërtetimitin e kompletësisë së të hyrave dhe kuantifikimin e shkallës së vjedhjeve e mashtrimeve në KEK gjatë viteve të përfunduara me 31 dhjetor 2002 dhe 31 dhjetor 2001.

2. Tatimi i paragjykuar

KEK-u nuk posedon dokumentacion përkatës për të vërtetuar lirimin e saj nga pagesa e tatimit të paragjykuar në përqindje prej 3% e të hyrave gjatë periudhës kohore prej 1 korrikut 2000 e deri me 31 mars 2002 dhe nuk është marrë përgjigje nga organet rregulative të Kosovës në kërkesën tonë që ato të konfirmojnë lejen për lirim. Dhe për këtë arsye, nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse mospërfshirja e obligimeve nga tatimi i paragjykuar me 31 dhjetor 2002 dhe me 31 dhjetor 2001, dhe shpenzimet rrjedhëse për këtë tatim, ishte e drejtë.

3. Të hyrat e jashtëzakonshme

Siç është paraqitur edhe në Shpalosjen 14 të bilancit financiar, të hyrat e jashtëzakonshme për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2002 kapnin vlerën prej 9,902 mijë EURO dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2001 kapnin vlerën prej 45,587 mijë EURO, të cilat përfshinin bartjet e zbalancimeve netto në mes të llogarive brenda kompanisë me 31 dhjetor 2002, respektivisht 31 dhjetor 2001. Menaxhmenti nuk ka bërë analizimin e këtyre diferencave dhe nuk ka patur sqarime për shkakun për paraqitjen e diferencave. Në bazë të kësaj, ne nuk ishim në gjendje të vlerësojmë efektet në bilancet financiare nëse do të evitoheshin drejtë transaksionet brenda kompanisë.

4. Obligimet nga fondi pensional

Siç është paraqitur edhe në Shpalosjen 8 të bilancit financiar, KEK-u ka obligim të ndajë mjete financiare për Fondin Pensional të KEK-ut. Sipas menaxhmentit të KEK-ut obligimet për këtë fond me 31 dhjetor 2002 llogariteshin të jenë 7,2 milion EURO. Por, kjo llogaritje nuk ishte bazuar në orarin sipas të cilit do të duhej të barteshin këto mjete, i cili ishte dhënë nga llogaritari i pranuar dhe, duke qenë gjendja kësisoj, ne nuk ishim në gjendje t'i plotësonim dëshirat tona për arsyeshmërinë e kësaj llogaritjeje deri me 31 dhjetor 2002.

5. Llogaritja e tatimit në fitim

Konform Rregullores të UNMIK-ut nr. 2002/3, date 20 shkurt 2002, e cila ka hyrë në fuqi me 1 prill 2002, KEK-u është obliguar të paguaj tatim në përqindjen prej 20% në fitimin e tatueshëm për periudhën 1 prill 2002 e deri me 31 dhjetor 2002, bazuar në llogaritjet të cilat i ofronin dispozitat e rregullores në fjalë. Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2002, KEK-u kishte raportuar humbjet kontabël prej 27,616 mijë EURO. Por, nuk ka ekzistuar ndonjë llogaritje zyrtare e tatimit në fitim që do të përcaktonte nëse KEK-u është i obligueshëm të paguaj tatim në fitim për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2002, sipas dispozitave të rregullores për tatimin në fitim, duke përfshirë shpenzimet e ndaluara siç janë provizionet et për borxhet të cilat nuk janë përcjellur sa duhet për të arritur arkëtimin e tyre. Në mungesë të një llogaritjeje të tillë të tatimit në fitim, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse mungesa e shpenzimeve për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2002 ishte e arsyeshme.

Shmangiet nga standardet ndërkombëtare të raportimit financiar

1. Prona, objektet dhe paisjet

Prona, objektet dhe paisjet janë paraqitur sipas shpenzimeve historike në të kaluarën, për të cilën menaxhmentit është i bindur se i afrohet shpenzimit e zhvlerësuar për zëvendësim.

Nuk ka patur vlerësim në datat e pasqyrave për shkallën e zhverësimit dhe nevojës për uljen e vlerës kontabël për shumën e llogaritur të realizueshme dhe pasqyrimin e humbjeve të zhvlerësimit, ashtu siç kërkohet nga Standardet ndërkombëtare të auditimit (International Standards on Auditing) IAS nr. 36 - për zhvlerësimin e mjeteve.

Në mungesë të këtij vlerësimi, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë shkallën e humbjeve të zhvlerësimit me 31 dhjetor 2002 dhe 31 dhjetor 2001.

Tutje, në këto bilance financiare nuk është përfshirë asnjë indeks i lëvizjeve që janë bërë në pronë, objekte dhe paisje, ashtu siç kërkohet nga IAS 16 për pronën, objektet dhe paisjet.

2. Ndhimat financiare

Që nga viti 1999 e këtej, KEK-u ka marrë ndihma financiare të konsiderueshme nga donatorët e jashtëm, të dedikuara kryesisht për riparimin dhe zëvendësimin e pronës, objekteve dhe paisjeve. Përkundër kërkesave të shumta, donatorët nuk ofruan dokumentacionin përkatës për të mundësuar që këto ndihma financiare të regjistrohen konform IAS-it nr. 20 – për kontabilitetin e ndihmave qeveritare.

3. Inventari

Nuk janë bërë provizione për pjesën e inventarit të vjetër apo me xhirim të ngadalshëm, që ishin pjesë e inventarit të tërësishëm të KEK-ut prej 47,710 mijë EURO me 31 dhjetor 2002 dhe 41,317 mijë EURO me 31 dhjetor 2001. Sipas IAS-it nr.3 – për inventarin, inventaret duhet të regjistrohen sipas çmimit më të ulët dhe vlerës neto të realizueshme, ashtu që të përkujdeset që mjete të mos jenë bartur në vlerë më të lartë se vlera reale, e cila duhet të përfitohet nga shitja apo përdorimi i tyre.

Opinionit nga auditimi

Për shkak të rëndësisë që çështjet e diskutuara në paragrafet paraprake bartin, shtrirja e punës tone nuk ishte e mjaftueshme që të na mundësohej shfaqja e opinionit, dhe ne nuk shprehim opinion në gjendjen financiare të KEK-ut me 31 dhjetor 2002, respektivisht, me 31 dhjetor 2001, apo për të arriturat në veprimtarinë e saj, për ndërrimet në kapitalin e pronarit dhe qarkullimin e parasë për vitet e mbyllura në atë kohë.

Potencim i çështjes

Duke mos e kualifikuar mendimin tone më shumë, dëshirojmë të terheqim vëmendjen tuaj në vërtjeten 3, e cila ka të bëjë me mungesën e titullarit të qartë të të drejtës mbi infrastrukturën e trashëguar me fillimin e administratës së KB-ve në Kosovë dhe në Shpalljen 18 për obligimet rezervë për eventualitetet.

Deloitte & Touche

Prishtinë,
31 mars 2003

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS (“KEK”)**FLETA E PASQYRËS
me 31 dhjetor**

		<i>2002</i>	<i>2001</i>
	<i>Vërejtje</i>	<i>EUR'000</i>	<i>EUR'000</i>
Mjetet themelore			
Mjetet themore jotrupore	3	9	12
Prona, objektet dhe paisjet		<u>526,785</u>	<u>552,965</u>
		526.794	552,977
Kreditë Afatgjate		80	77
Aktiva xhiruese			
Inventari	4	47.710	43,317
Shkëmbimi dhe arkëtueshmëritë tjera	5	39.938	21,333
Paraja dhe ekuivalentet në para	6	<u>4.214</u>	<u>807</u>
		57.952	52.317
Aktiva e përgjithshme		618.735	616.511
Kapitali i pronarit			
Kapitali	7	675.485	675.485
Humbjet e akumuluar		<u>(94.486)</u>	<u>(66.870)</u>
		580.999	608.615
<i>Pagueshmëritë: shumat që arrihen vetëm pas më shumë se një vit</i>			
Obligimet e akumuluar afatgjate për detyrimet pensionale	8	4,800	-
Kreditë afatgjate		<u>56</u>	<u>56</u>
		4.856	56
<i>Pagueshmëritë: shumat që arrihen vetëm pas më shumë se një vit</i>			
Të hyrat e vonuara	9	10.833	-
Shkëmbimi dhe pageshmëritë tjera	10	<u>22.048</u>	<u>7.840</u>
		32.881	7.840
KAPITALI I PËRGJ. DHE OBLIGIMET		618.736	616.511

Vërejtjet në bilancet financiare janë pjesë përbërëse e këtyre bilanceve financiare

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS (“KEK”)

PASQYRA E TË HYRAVE
Për vitet e përfunduara me 31 dhjetor

		<i>2002</i>	<i>2001</i>
	<i>Vërejtje</i>	<i>EUR'000</i>	<i>EUR'000</i>
Të hyrat			
Të hyrat nga energjia elektrike	11	127.744	92,708
Ndihmat financiare	9	24.460	70.986
Të hyrat tjera		2,615	7,266
Të hyrat e përgjithshme operacionale		154.819	170.960
Shpenzimet			
Shpenzimet materiale		(12,763)	(13,873)
Stoqet dhe shërbimet		(1,430)	(1,096)
Shpenzimet e enrgjisë elektrike	12	(35,408)	(53,479)
Shpenzimet në pagat e punëtorëve		(30,067)	(23,729)
Shpenzimet ushqimore		(1,556)	(1,769)
Shp. për financimin e fondit pensional	8	(7,200)	-
Shpenzimet tjera të punëtorëve		(3,919)	(3,455)
Zhverësimi dhe amortizimi		(52,337)	(66,455)
Posedimi në prone, objekte dhe paisje		(1,024)	(220)
Inventari i shlyer		(957)	(56)
Ndarjet për borxhet e këqija	5	(33,644)	(71,132)
Shpenzimet e mirëmbajtjes		(3,359)	(2,636)
Shpenzimet për shërbimet e bartjes		(827)	(652)
Shpenzimet tjera ndihmëse		(1,299)	(1,681)
Shpenzimet tjera shërbyese		(1,968)	(1,759)
Shpenzimet gjyqësore	10	(924)	-
Tatimi për ekstraktimin e qymyrit	10	(1,116)	-
Tjera		(2,435)	(1,697)
Shpenzimet e përgjithshme operacionale		(192,233)	(243,689)
Humbjet operacionale		(37,414)	(72,730)
Shpenzimet neto financiare		(104)	(230)
Humbjet netto para tatimit në të hyra dhe pjesët e jashtzakonshme		(37,518)	(72,960)
Të hyra netto të jashtëzakonshme	13	9,902	45,587
Humbjet netto para tatimit në fitim		(27,616)	(27,372)
Tatimi në fitim		-	-
Humbjet netto për vitin		27,616	27,372

Vërejtjet në bilanci financiarë janë pjesë përbërëse e këtyre bilanceve financiare

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS (“KEK”)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN PRONARIT
Për vitet e përfunduara me 31 dhjetor

	<i>Kapitali</i>	<i>Humbjet e</i> <i>akumuluar</i>	<i>Totali</i>
	<i>EUR'000</i>	<i>EUR'000</i>	<i>EUR'000</i>
<i>Me 1 janar 2001</i>	675.485	(39.498)	635.987
Humbjet netto në këtë vit	<u>-</u>	<u>(27.372)</u>	<u>(27.372)</u>
<i>Bilancime 31 dhjetor 2001</i>	675.485	(66,870)	608,615
Humbjet netto në këtë vit	-	<u>(27.616)</u>	<u>(27.616)</u>
<i>Me 31 dhjetor 2002</i>	<u>675.485</u>	<u>(94.486)</u>	<u>580.999</u>

Vërejtjet në bilancet financiare janë pjesë përbërëse e këtyre bilanceve financiare

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS (“KEK”)**PASQYRA E RRJEDHËS TË PARASË**
Për vitet e përfunduara me 31 Dhjetor

	<i>2002</i>	<i>2001</i>
	<i>EUR'000</i>	<i>EUR'000</i>
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative		
Netto humbjet para tatimit në të hyra	(27.616)	(27.327)
Përshtatjet për:		
Zhvlerësim/amortizim.	52.334	66.455
Humbjet në posedimet e pronës, objekteve dhe paisjeve	1.024	220
Inventori i shlyer	957	56
Dhënie për arkëtueshmëritë e dyshimta	33.644	71,132
Të hyrat netto nga shkëmbime	60.343	110,491
Zvogëlim i inventarit	(7.350)	(22,211)
Rritje e arkëtueshmërive	(52.250)	(52,205)
(Zvogëlim)/Rritje në pagueshmëritë e arritura pas më gjatë se një vit	4.800	(7,994)
(Zvogëlim)/Rritje në pagueshmëritë e arritura brenda një viti	25,042	(19,270)
Netto qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative	30.585	8,811
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet investive		
Blerjet në pronë, objekte dhe paisje	(27.175)	(15,254)
netto paratë e gatshme për aktivitetet investive	(27.175)	(15,254)
Para të gatshme nga aktivitetet financiare		
Zvogëlim/(Rritje) në arkëtueshmëritë afatgjate	(3)	(77)
Netto para të gatshme nga aktivitetet financiare	(3)	(77)
Netto (Zvogëlim)/Rritje në para të gatshme dhe ekuivalente të parasë	3,407	96,520)
Para të gatshme dhe ekuivalente të parasë me 1 Janar	807	7,327
Para të gatshme dhe ekuivalente të parasë me 31 Dhjetor (Shp. 6)	4,214	807

Vërejtjet në bilanci financiarë janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. HYRJE

Siaps Rezolutës së Kombeve të Bashkuara nr. 1244, Misioni i Përkohshëm i Administrimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u) është veshur me të drejtën e administrimit të pronës të luajtshme dhe të paluajtshme, e cila është e regjistruar në emër të ish Republikës Federative të Jugosllavisë apo Republikës të Serbisë apo organeve të saj në territorin e Kosovës.

Në mbikëqyrjen e UNMIK-ut, Korporata Energjetike e Kosoves (“KEK”) është themeluar në vitin 1999 nga UNMIK-u sipas Rregullores No. 1999/12. Synimi kryesor ishte qeverisja e pronës të ish Kompanisë elektro-energjetike të Kosovës, ashtu që të sigurohet furnizimi i popullatës në Kosovë me energji elektrike.

KEK-u ka filluar veprimtarinë në qershor të vitit 1999.

KEK-u nuk është e regjistruar si ndërmarrje dhe statusi ligjor i pronësisë mbi infrastrukturën është i paqartë. Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) është themeluar në qershor 2002 për të ushtruar funksionin e përfaqësuesit të pronarëve.

2. POLITIKAT E KONTABILITETIT

a. Të përgjithshme

Bilancet financiare të KEK-ut janë sajuar në pajtim me konventën për shpenzimet historike. Njësia monetare raportuese e KEK-ut është Njësia Monetare Evropiane (EUR). Në pajtim me rregullativën e Unionit Monetar Evropian dhe me instruksionet e lëshuara nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (BPK), EUR është pranuar si njësia e vetme monetare zyrtare në territorin e Kosovës nga 1 janari 2002, dhe, rrjedhimisht, vlerat zyrtare në marka gjermane (DEM) janë konvertuar në EUR nga 1 janari 2002 e tutje duke përdorur kursin zyrtar të këmbimit $1 \text{ EUR} = 1.95583 \text{ DEM}$.

Kontinuiteti në ushtrimin e veprimtarisë si bazë për kontabilitet

Bilancet financiare të KEK-ut janë sajuar nën supozimin se KEK-u do të ketë kontinuitet në ushtrimin e veprimtarisë. Aktualisht, KEK-u varet shumë nga ndihma financiare nga jashtë për të qenë në gjendje për të vazhduar veprimtarinë e saj. Bilancet financiare supozojnë se do të ketë donacione të mjaftueshme nga bashkësia ndërkombëtare që do t'i mundësojnë KEK-ut pagesën e borxheve të saj sipas arritshmërisë dhe nuk parashohin përshtatje të cilat do të mund të kërkoheshin për të vlerësuar aktivën dhe arritshmërinë e obligimeve, nëse kjo nuk do të ndodhte.

b. Baza për përgatitjen e bilanceve financiare

Këto balance financiare janë sajuar konform me standardet dhe interpretimet e miratuara nga Bordi për Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (International Accounting Standards Board “IASB”) të cilat janë të njohura edhe si Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (International Financial Reporting Standards “IFRS”). Këto standarde në të kaluarën njiheshin edhe si Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit (International Accounting Standards – “IAS”). Politikat kryesore të kontabilitetit të adoptuara nga KEK-u janë shkoqitur më poshtë.

c. Valutat e jashtme

Transaksionet zyrtare në valutat e jashtme fillimisht janë regjistruar sipas kursit të këmbimit që ka mbizotëruar në momentin e transaksionit. Aktiva dhe pasiva monetare në valutë të jashtme janë përlogaritur në EUR sipas kursit zyrtar të këmbimit që ka mbizotëruar në kohën e pasqyrës financiare. Fitimet apo humbjet eventuale që kanë rezultuar janë pranuar në Pasqyrën e të hyrave.

Kursi në fuqi zyrtar i BPK-së (nga EUR në valutën e jashtme) për njësinë kryesore valutore me 31 dhjetor ishte, si vijon:

	2002	2001
United States Dollar (“USD”)	1.0151	1.1069

d. Prona, objektet dhe paisjet

Prona, objektet dhe paisjet janë paraqitur sipas vlerës historike duke zbritur amortizimin, i cili i ngarkohet Pasqyrës të të hyrave në bazë lineare përgjatë gjithë përdorimit të llogaritur të tyre:

Ndërtesat	1.5 deri 5%
Instalimet teknike dhe paisjet	5 deri 20%
Pjesët reserve dhe mjetet tjera	5 deri 16.5%

Normat e lartëcekura të amortizimit janë përcaktuar sipas nomenklaturës së pronës, objekteve dhe paisjeve të miratuara nga Bardi Ekzekutiv, dt. 18 maj 2001, i cili kishte hyrë në fuqi nga 1 janari 2001. Sa i përket tokës dhe punëve ndërtimore në kryerje, për to nuk është paraqitur amortizimi.

Menaxhmenti mendon se vlera historike i afrohet vlerës të zëvendësimit në amortizim para llogartijes të humbjeve në zhvlerësim.

e. Zhvlerësimi i mjeteve

Vlera kontabël e mjeteve nuk është përshtatur për humbjet në zhvlerësim. Situata e tanishme në Kosovë e bën llogaritjen e qarkullimit të ardhshëm të parasë jashtëzakonisht të vështirë dhe bashkësia ndërkombëtare është duke ndihmuar në servisimet dhe renovimet në objekte dhe paisje.

f. Rezervat minerare

KEK-u ka qasje në rezervat e gjaera minerarë. Për këto rezerva nuk është përcaktuar ndonjë vlerë në këto balance financiare (shih Shpalosjen 18).

g. Mjetet themelore të paluajtshem (jotrupore)

Mjetet themelore jotrupore janë paraqitur sipa vlerës historike duke hequr amortizimin, i cili ngarkohet në Pasqyrën e të hyrave sipas bazës lineare me normë prej 20% në vit.

h. Inventari

Inventari është regjistruar sipas kostos më të ulët dhe vlerës netto të realizueshme. Kostoja përfaqëson vlerën sipas faturës të mallrave të pranuar. Inventari bartet në shpenzim duke përdorur metodën e kostos mesatare.

i. Të hyrat

Të hyrat pranohen me dorëzimin e mallrave dhe të produkteve.

j. Arkëtueshmëritë

Arkëtueshmëritë janë paraqitur sipas vlerës netto e cila pritet të realizohet, dhe janë modifikuar për provizionet për borxhet e këqija.

k. Vlera reale e instrumenteve financiare

Vlera reale e instrumenteve të caktuara financiare, duke përfshirë paranë dhe ekuivalentët e parasë, arkëtueshmëritë dhe pagueshmëritë, të cilat arrihen brenda një viti, i afrohet vlerës reale, kështu, ngase arritshmëria është e shkurtë. Sipas mendimit të menaxhmentit, vlerat e tashme të pagueshmërive të cilat arrihen në afat kohor më të gjatë se një vit i përafrohen vlerës reale.

l. Grantet

Grantet e pranuar me qëllime të sigurimit të mjeteve të pronës, objektet dhe paisjeve janë regjistruar si të hyra të shtyera në pasqyra dhe lirohet përgjatë të njëjtës periudha sa është edhe jetëgjatësia e mjeteve të pranuar nga grantet.

Grantet për shpenzimet operative pranohen në Pasqyrën e të hyrave në periudhën për të cilën ka të bëjë shpenzimi relevant sipas vlerës reale të beneficionit të pranuar.

m. Shpenzimet për huazim

Kamata në të hyra dhe shpenzime kreditohet dhe detohet në kamatën në të hyra dhe shpenzime sipas arritjes.

n. Tatimimi i paragjykuar dhe në fitim

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2001 dhe për periudhën tremujore të përfunduar më 31 mars 2002, KEK-u detyrohej të paguaj tatim të paragjykuar sipas norms 3% nga të hyrat bruto kuartale që tejkalojnë shumën prej 15.000 DEM, sipas Rregullores të UNMIK-ut nr. 2000/29, e lëshuar më 20 maj 2000.

Në korrik 2001, Menaxhmenti i KEK-ut ishte këshilluar nga UNMIK-u që të mos vazhdojë me pagesën e tatimit të paragjykuar, përderisa të mos mirret ndonjë këshillë tjetër nga Autoriteti Qendror Fiskal (“AQF”) që të gjitha ndërmarrjet që ofrojnë shërbime publike janë të lira nga ky tatim. Në këto Pasqyra financiare nuk është paguar e as nuk është përllogaritur ndonjë shumë për tatimin e paragjykuar.

Nga 1 prilli 2002, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/3, nga KEK-u është kërkuar që të paguaj tatim në fitim sipas norms prej 20% të fitimit të tatueshëm, siç parashohin llogaritjen dispozitat e kësaj rregulloreje.

o. Tagrat e punëtorëve

Në këto Pasqyra financiare janë paraparë disa provizione për shpenzimet e llogaritura të ardhshme për të drejtat pensionale, ashtu siç janë paraqitur në statutin e pensionit suplementar të KEK-ut të themeluar gjatë teorit 2002.

p. Njohja e shpenzimeve të rehabilitimit dhe obligimeve

Nuk është paraparë asnjë provizion në Pasqyrat financiare për shpenzimet në punët eventuale të rehabilitimit të minierave të qymyrit, apo shpenzimet për largimin e lendëve të kontaminuara nga pjesët tjera të pronës së KEK-ut (shih Shpalosjen 17).

r. Shpenzimet për zhvillimin e minierave

Shpenzimet për zhvillimin e minierave mbulohen me paraqitjen e tyre. Nuk janë paraparë provizione për shpenzimet e punët zhvillimore të nevojshme, por që ende nuk janë kryer. (shih shpalosjen 16).

s. Provizioni për mirëmbajtjen e makinerisë dhe paisjeve

Shpenzimet e mirëmbajtjes preventive të mjeteve në miniera, gjenerim dhe distribucion mbulohen me paraqitjen e tyre. Nuk janë paraparë provizione për ngeçjet në mirëmbajtjen preventive e nevojshme për kthimin e makinerisë në gjendje të sigurtë për funksionim.

t. Përdorimi i llogaritjeve

Sajimi i Pasqyrave financiare në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar “IFRS”, kërkon nga menaxhmenti bërjen e llogaritjeve dhe presupozimeve të cilat ndikojnë në vlerën e aktivës dhe pasivës të raportuar dhe zbulimin e aktivës dhe pasivës rezerve në kohën e Pasqyrave financiare, dhe vlerat e raportuara të të hyrave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto llogaritje.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS (“KEK”)

3. PRONA, OBJEKTET DHE PAISJET

	<i>Toka</i>	<i>Ndërtesat</i>	<i>Paisjet</i>	<i>Pjesët reserve dhe tjera</i>	<i>Punët në kryerje</i>	<i>Totali në prone, objekte dhe paisje</i>
	<i>EUR'000</i>	<i>EUR'000</i>	<i>EUR'000</i>	<i>EUR'000</i>	<i>EUR'000</i>	<i>EUR'000</i>
<i>Kosto me 31 dhjetor 2001,</i>	129.888	122,031	741,536	399	7.031	1.000.885
<i>Amortizimi netto i akumuluar me 31 dhjetor 2001</i>	-	(4,198)	(443,675)	(47)	-	(447.920)
Vlera neto kontabël me 31 dhjetor 2001	129.888	117,833	297.861	352	7.031	552.965
<i>Kosto me 31 dhjetor 2002,</i>	130,862	120,949	749,116	209	7,655	1,008,791
<i>Amortizimi netto i akumuluar me 31 dhjetor 2002</i>	-	(8,359)	(473,585)	(62)	-	(482,006)
Vlera neto kontabël me 31 dhjetor 2002	130,862	112,590	275,531	147	7,655	526,785

Kontestet rreth pronësisë ekzistojnë ende sa i përket infrastrukturës të trashëguar me fillimin e Administrimit të KB-ve në Kosovë. Meqë mjetet ishin pjesë e Ndërmarrjes së atëhershme elektro-energjetike Jugosllave, mund të ekzistojnë kërkesa pronëso-ro-juridike nga ajo ndërmarrje të cilat kërkojnë adresim në të ardhmen.

4. INVENTARI

	31 dhjetor 2002	31 dhjetor 2001
	EUR'000	EUR'000
Lënda e pare dhe materiali i harxhueshëm	29.327	28.420
Punët në kryerje	307	389
Derivate	2,045	757
Pjesë rezervë	8,648	8,828
Material tjetër dhe furnizime	<u>7,383</u>	<u>2,923</u>
Inventari gjithsejt	<u>47.710</u>	<u>41.317</u>

5. ARKËTUESHMËRITË

	31 dhjetor 2002 EUR'000	31 dhjetor 2001 EUR'000
Llogaritë e arkëtueshme të shkëmbimit – të vendit	136,768	88,640
Llogaritë e arkëtueshme të shkëmbimit – të jashtme	<u>7,946</u>	<u>3,825</u>
Provizioni për arkëtueshmëritë e dyshimta	<u>(104,776)</u>	<u>(71,132)</u>
Arkëtueshmëritë gjithsejt	<u>39,938</u>	<u>21,333</u>

Lëvizjet në provision për arkëtueshmëritë e dyshimta është si vijon:

	31 dhjetor 2002 EUR'000	31 dhjetor 2001 EUR'000
Bilanci në fillim të vitit	71,132	-
Provizioni për arkëtueshmëritë e dyshimta	<u>33,644</u>	<u>71,132</u>
Bilanci në fund të vitit	<u>104,776</u>	<u>71,132</u>

Provision për arkëtueshmëritë e dyshimta është llogaritur si vijon

Kategoria sipas vjetërsisë	% Provizionit	31 dhjetor 2002 EUR'000	31 dhjetor 2001 EUR'000
Mbi 12 muaj	100	72,251	49,205
Prej 6 muaj deri 12 muaj	75	12,923	9,384
Prej 3 deri 6 muaj	50	7,461	4,775
Më pak se 3 muaj	10	2,313	1,480
Rastet sociale dhe tjera	100	<u>9,828</u>	<u>6,288</u>
Bilanci në fund të vitit		<u>104,776</u>	<u>71,133</u>

6. PARA E GATSHME NË DORË/PËRDORIM DHE NË BANKA

	31 dhjetor 2002	31 dhjetor 2001
Paratë e gatshme në banka	EUR'000	EUR'000
Autoriteti bankar dhe i pagesave i Kosovës (“BPK”)	2,078	592
Micro Enterprise Bank, Kosovë	380	63
American Bank Kosovë	287	1
Banka e re e Kosovës	7	1
Banka ekonomike e Kosovës	200	1
Banka Private e Biznesit, Kosovë	5	-
Kassabanka, Kosovë	706	-
Banka Kreditore, Kosovë	13	-
Bilanci në fund të vitit	3,676	658
Para në përdorim	538	149
Para të gatshme- gjithsejt	4,214	807

7. KONTRIBUTET KAPITALE

Për herë të parë regjistrimi i kapitalit të KEK-ut që nga 1 janari 2000 sipas vlerës kontabël të pronës, objekteve dhe paisjeve, inventarit dhe parasë të gatshme, është identifikuar kur KEK-u startoi me veprimtarinë e saj në qershor 1999. Kjo vlerë kapitale akoma nuk është regjistruar zyrtarisht nga institucione relevante të autorizuara.

8. KËRKESAT E GRUMBULLUARA PËR OBLIGIMET PENSIONALE

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/35 dhe në bashkërendim me BPK-në, nga KEK-u ishte kërkuar themelimi i fondit të veçantë pensional për ish punëmarrësit. Statuti i fondit pensional është përpiluar dhe miratuar nga Bordi Ekzekutiv i KEK-ut me 1 nëntor 2002 dhe ky fond përfundimisht është liçencuar zyrtarisht nga BPK-ja me 18 dhjetor 2002.

Statuti i fondit pensional njih këto kategori të përfituesve nga Fondi Pensional:

- **Kategoria A:** Ish punëtorët e KEK-ut më të moshuar se 60 vite apo që posedojnë përvojë punë më shumë se 35 vite në KEK (pension mujor prej 105 EURO);
- **Kategoria B:** Ish punëtorët e KEK-ut që kanë shkëputur marrëdhënien e punës për shkak për shkak të paaftësisë së kualifikuar për punë, të drejtë të përfitojnë nga pensioni ekzistues (pension mujor prej 105 EURO);
- **Kategoria C:** Përfituesit nga ish punëtorët e KEK-ut të cilën kanë humbur jetën në vend të punës (pension mujor prej 295 EURO);
- **Kategoria D:** Përfituesit nga ish punëtorët e KEK-ut të cilët janë shpallur të zhdukur gjatë konfliktit të vitit 1999 (pension mujor prej 153 EURO); and
- **Kategoria E:** Përfituesit nga ish punëtorët e KEK-ut të cilën kanë humbur jetën gjatë konfliktit të vitit 1999 (pension mujor prej 100 EURO).

Sipas statutit të Fondit Pensional, KEK-u është i obliguar të sigurojë fonde për fondin pensional sipas orarit të bartjes së fondeve, të caktuar nga llogaritari i certifikuar. Ky ende duhet të përpunohet, por menaxhmenti ka llogaritur kërkesat për këtë fond deri me 31 dhjetor 2002, në vlerë prej 7,200 mijë, e zbërthyer;

	EURO' 000
Kërkueshmëria brenda një viti	2.400
Kërkueshmëria më gjatë se një vit	
Vlera reale e actives së planifikuar	<u>4.800</u>
Obligimet për fondin pensional - gjithsejt	<u>7,200</u>

Gjat viti të mbyllur me 31 dhjetor 2002, si shtesë e shpenzimeve për fondin e lartëpërmendur, KEK-u iu ka paguar ish punëtorëve penzionet në shumë prej 1,509 mijë EURO (2001: 1,868 mijë EURO).

9. TË HYRAT E SHTYERA

	31 dhjetor 2002 EUR '000	31 dhjetor 2001 EUR '000
<i>Obligimet për tatimet e shtyera në të hyra - gjithsejt</i>	<u>10,833</u>	<u>-</u>

Të hyrat e vonuara paraqesin pronën, objektet dhe paisjet e dhëna nga donacionet nga donatorë të ndryshëm. Lëvizja në të hyra të vonuara paraqitet si vijon

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2002 (EUR 000)	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2001 (EUR 000)
Bilanci në fillim të vitit	-	-
Donacionet për importin e energjisë gjatë vitit	22,963	70,986
Donacionet për importin e energjisë e transferuar në të hyrat nga grantet gjatë vitit	(22,963)	(70,986)
Donacionet në pronë, objekte dhe paisje gjatë vitit	12,330	-
Donacionet në pronë, objekte dhe paisje e transferuar në të hyra nga grantet gjatë vitit	<u>(1,497)</u>	<u>-</u>
Bilanci në fund të vitit	<u>10,833</u>	<u>-</u>

Importi i energjisë elektrike ndërlidhet kryesisht me energjinë nga Bullgaria, që ka qenë donacion e Agjencionit European të Rindërtimit (AER-i).

Në vitin 2000 si dhe në vitet paraprake, KEK-u ka marrë ndihmë të gjërë nga donatorët ndërkombëtarë për t'i ndihmuar me riparimet dhe servisimet gjenerale të infrastruktures, e cila ka qenë në një gjendje të mjerueshme sa i përket mirëmbajtjes dhe ishte dëmtuar gjatë luftës. Edhe përkundër kërkesës për të dhëna nga donatorët, janë dorëzuar vetëm disa të dhëna të parëndësishme për detajet rreth shpenzimeve dhe vlerës reale të këtyre ndihmave, dhe si të tilla nuk na mundësojnë që përfitimet të pasqyrohen në këto Pasqyra financiare.

10. SHKËMBIMI DHE PAGUESHMËRITË TJERA

Shkëmbimi dhe pagueshmëritë tjera mund të përmbli dhe si vijon:

	31 dhjetor 2002 EUR'000	31 dhjetor 2001 EUR'000
Obligimet e grumbulluara nga fondi pensional të pagueshme brenda vitit (Shih Shpalosjen 8)	2,400	-
Llogaritë e pagueshme nga shkëmbimi - të vendit	4,788	2,729
Llogaritë e pagueshme nga shkëmbimi - të jashtme	602	1,433
Shpenzimet gjyqësore	924	-
Tatimi për ekstraktim	1,116	-
Kredi afatshkurte	13	13
Llogaritë nga obligimet e pagueshme	9,843	4,174
Pagueshmëritë për TVSH	8,746	656
Obligimet ndaj punëtorëve	3,469	3,009
Shkëmbimi dhe pagueshmëritë tjera - gjithsej	32.094	20.582

Shuma prej 924 mijë eurosh ka të bëjë me shpenzimet gjyqësore nga 1997 deri 2002, për paditë pronësore të ushtruara kundër KEK-ut.

Tatimi për ekstraktimin e xeheve minerare në shumë prej 1,116 mijë eurosh më këtë tatim për periudhën 18 mujore deri 31 dhjetor 2002. Tatimi për ekstraktimin e qymyrit bazuar në përqindjen 0,25 euro për ton qymyr.

Ky tatim për ekstraktimin e qymyrit paraqesin të hyra për komunën dhe KEK-u do të paguaj atë pas marrëveshjes, në këste.

11. TË HYRAT NGA ENERGJIA

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2002 (EUR 000)	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2001 (EUR 000)
Konsumatorët e energjisë me shumicë dhe pakicë	106,203	82,730
Shitja e qymyrit	1,729	1,330
Tjera	2,998	1,416
Eksporti i energjisë	16,814	7,232
Të hyrat e përgjithshme nga energjia	127,744	92,708

12. SHPENZIMET E ENERGJISË

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2002 (EUR 000)	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2001 (EUR 000)
Importi i energjisë elektrike	21,683	44,112
Derivatet	13,278	9,036
Shërbimet e ujit	<u>447</u>	<u>331</u>
Të hyrat e përgjithshme nga energjia	<u>35,408</u>	<u>53,479</u>

13. TË HYRAT NETTO TË JASHTËZAKONSHME

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2002 (EUR 000)	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2001 (EUR 000)
Pagueshmëritë e shlyera brenda kompanisë	27,431	49,296
Pagueshmëritë e panjohura të shlyera	506	2,428
Të hyrat brenda kompanisë	4,729	-
Të hyrat e panjohura	<u>1,883</u>	<u>-</u>
Gjithsejt të hyrat e jashtëzakonshme	<u>35,549</u>	<u>51,724</u>
Arkëtueshmëritë e shlyera brenda kompanisë	(18,236)	-
Arkëtueshmëritë e tjera të shlyera	-	(6,137)
Shpenzimet e panjohura	<u>(6,411)</u>	<u>-</u>
Gjithsejt shpenzimet e panjohura	<u>(24,647)</u>	<u>(6,137)</u>
Gjithsejt të hyrat e jashtëzakonshme, netto	<u>9,902</u>	<u>45,587</u>

Pagueshmëritë dhe arkëtueshmëritë të shlyera brenda kompanisë kanë të bëjnë me bilancet e pabarazuara brenda kompanisë në mes të drejtorësë dhe degëve/divizioneve të KEK-ut. Shpenzimet e panjohura kanë të bëjnë me bilancet e vitit të kaluar të shlyera gjatë vitit 2002.

14. PUNËTORËT

Numri i punëtorëve me 31 dhjetor 2001 dhe 2002 ishte 9,539 dhe 9,359 respektivisht

15. REZERVAT MINERARE

KEK-u është operuesi i vetëm i dy minierave të tanishme active të qymyrit, MS Bardhi dhe MS Mirashi, përafërsisht të shtrira në një zone minuese prej 9 km².

Gjatë vitit 2000, muaji gusht, Konsortiumi STEAG kishte përgatitur studimin e fizibilitetit për “Furnizimi i Kosovës me energji elektrike”, dhe ata kishin konkluduar se rezervat e eksploatueshme në zonat minuese active ishin përafërsisht 80 miljon ton, me raport djerrinë – qymyr 1.05 : 1. Rezerva më e madhe rreth 73 miljon tongjendet në rripin në mes të Mirashit përendimor dhe Bardhit.

16. MUNGESA NË SHPENZIMET PËR ZHVILLIMIN E MINIERAVE

Gjatë disa viteve të fundit, boshllëku në shpenzimet për zhvillimin e minierave ka shkaktuar krijimin e një gjendje ku shkalla e pjerrtësisë është aq e lartë sa shpatet janë jostabile. Tejkalmi i këtij problemi dhe sanimi i këtyre pjerrtësive do ta bëjë të domosdoshme shpenzimin signifkant përgjatë vitet të ardhshme.

Nuk janë bërë provizione në këto bilance financiare për shpenzimet e llogaritura për sanuar problemin.

17. MUNGESA NË SHPENZIMET PËR MIRËMBAJTJE

Përgjatë fiteve të fundit është krijuar një boshllëk në mirëmbajtjen e përditshme, i cili ka arritur seri në atë shkallë sa pjesët e rëndësishme të sistemit të gjenerimit dhe distributionit janë në gjendje të mjerueshme dhe nevojitet punë e rëndësishme renovuese për ta tejkualuar këtë problem.

Nuk janë bërë provizione në këto bilance financiare për shpenzimet për punët riparuese.

18. OBLIGIMET REZERVË

Borxhi afatgjatë

Menaxhmenti është i bindur se kreditë afatgjate signifkante, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e infrastrukturës energjetike në Kosovë, mund të të jenë akumuluar nga koha e udhëheqjes sebe, por, nuk ekzistojnë regjistra për të përcaktuar vlerën apo statusin e tanishëm të këtyre obligimeve. Natyra dhe vëllimi i obligimeve të caktuara, si dhe përgjegjësia në të ardhmen për obligimet e tilla, paraqet çështje e cila duhet të përcaktohet në të ardhmen si pjesë e shqyrtimeve më të gjëra.

Të drejtat minerare

Drejtorati i Minerave dhe Mineraleve në Kosovë është këshilluar se KEK-u nuk posedon aktualisht me licencën për eksploitim apo koncesion për mihjen e qymyrit.

Pjesë e kushteve për marrjen e pëlqimit për koncesion për mihjen e qymyrit do të jetë eventualisht obligimi për të ndërmarë punë rehabilituese dhe largimin e lëndëve të kontaminuara. Kjo paraqet një obligim potencial, i cili nuk është përllogaritur në këto bilance financiare.